

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kongo përballet me shpërthimin më të rëndë të Ebolës, mbi 7 mijë raste dhe afro 4 mijë viktima
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/kongo-perballet-me-shperthimin-me-te-rende-te-eboles-mbi-7-mije-raste-dhe-a-i585728
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 07:24:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 07:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9b5892031a2d79ea3a334f0068c9866dd73715e1c5b7dcc4bd81ce4a78e9cc40
TEKSTI	b76c03a107e46fa465adca4cbce8093eebc2fd9f584a12f5ef6cbcddc4760353
PAMJA	f056b3e9fdabf7704af30842d0cf6efbd3fbda208bd8f459cbaee12b84b68512

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cb42f15db39d96b761f2f8ba8900888618f55cf660ef408d98fd0b912fd60828
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a57398cf8eb56e5c3824c7ad1d9738b2b29a5a5940aff90c94875084de23f115
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cb42f15db39d96b761f2f8ba8900888618f55cf660ef408d98fd0b912fd60828>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



[English](#)



1 e [Kikthim emocionues për Celine Dion, koncerti i parë i plotë pas më shumë se gjashtë viteshZgjedhje vendimtare në Suedi, ekstremi i djathtë vetëm një hap larg pushtetit Iritoli në banesën e mesu fundit](#)

Kongo përballet me shpërthimin më të rëndë të Ebolës, mbi 7 mijë raste dhe afro 4 mijë viktima

13 Shtator 2026, 09:40Bota TEMA



 Kongo përballet me shpërthimin më të rëndë të

Numri i rasteve të konfirmuara të Ebolës në Republikën Demokratike të Kongos ka tejkaluar 7,000, ndërsa vendi përballet me shpërthimin e tij më të keq në histori, megjithëse mund të ketë kaluar kulmin e tij, sipas autoriteteve në Kinshasa.

Republika Demokratike e Kongos shpalli shpërthimin e 17-të të Ebolës në mesin e majit. Sëmundja, e cila zakonisht është vdekjeprurëse, ka vrarë tashmë më shumë se 15,000 persona në Afrikë gjatë 50 viteve të fundit.

Shpërthimi, i përqendruar në provincën verilindore të Iturit, ka prekur kryesisht lindjen dhe veriun e vendit, zona të izoluarat të shkatërruara nga trazirat, dhe reagimi i autoriteteve shëndetësore nuk ka qenë i mjaftueshëm për të përmbajtur shpërthimin e rasteve.

Këtë javë, epidemia është përhapur në një provincë të shtatë, Ubangi Jugor, e cila kufizohet me Republikën Qendrore Afrikane dhe Kongo-Brazzaville.

Deri më sot, autoritetet thonë se kanë regjistruar 7,022 raste të konfirmuara në laborator, 3,998 vdekje dhe 1,671 shërimet.

“Kulmi u kalua në fillim të javës së tretë të gushtit”, siguroi zëdhënësi i qeverisë Patrick Muyaya nëpërmjet X të shtunën.

“Të gjithë parametrat tregojnë një rënie të numrit të rasteve”, vazhdoi ai, duke sqaruar se në “10 nga 61 zonat shëndetësore” të prekura nga epidemia, nuk janë regjistruar raste të reja “për të paktën 21 ditë”.

Epiqendra e epidemisë mbetet provinca Ituri, ku shumica dërrmuese e rasteve janë konfirmuar.

Infeksionet me Ebola janë raportuar në shkolla vetëm disa ditë para vitit të ri shkollor, duke shkaktuar shqetësim të madh tek prindërit dhe punonjësit e shëndetësisë, thanë për AFP burime në sistemin arsimor të vendit.

“Jemi shumë të shqetësuar sepse nuk e dimë se cili fëmijë është nga cila familje ose cila është gjendja shëndetësore e anëtarëve të kësaj familjeje”, tha Angel Magani, nëna e një studenti të ri në Bunia, kryeqytetin e provincës.

“Jemi shumë të frikësuar, megjithëse administrata e shkollës na siguron për masat shëndetësore që po zbatohen”, shtoi ajo.

“Ekziston një dispozitë për larjen e detyrueshme të duarve me sapun dhe ne po bëjmë gjithçka që është e mundur që të kemi një maksimum prej 30 nxënësish në secilën klasë”, tha për AFP-në Roger Mungibo, një administrator shkollë në Bunia.

Agjencitë që merren me reagimin ndaj epidemisë theksojnë se financimi nuk është i mjaftueshëm për të garantuar izolimin dhe mbikëqyrjen e pacientëve.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) vlerësoi të martën se nevojiten 5,000 punonjës të tjerë shëndetësorë për t’u përballur me epideminë.

Trajtime dhe vaksina të ndryshme po testohen aktualisht kundër llojit Budibugio të virusit, i cili është përgjegjës për epideminë aktuale, pasi deri më sot nuk ka përgatitje të miratuar për të.

Epidemia e dytë më vdekjeprurëse e Ebolës në Republikën Demokratike të Kongos, një vend i gjerë në Afrikën qendrore, ka vrarë gati 2,300 pacientë nga një total prej 3,500 rastesh të regjistruara në periudhën 2018-2020.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Zgjedhje vendimtare në Suedi, ekstremi i djathtë vetëm një hap larg pushtetit](#)

09:10 Bota

[Qindra emigrantë të dëbuar nga Britania zhduken në Francë, Parisi kërkon anulimin e marrëveshjes dypalëshe](#)

08:30 Bota / 2 komente

[Dalja e trenit nga shinat në Normandi, dyshohet për sabotazh](#)

08:11 Bota / 1 koment

[Trump akuzon Iranin për sulmin ndaj tubacionit të naftës në Arabinë Saudite](#)

08:00 Bota / 1 koment

[Panik në Bruksel/ Droni i panjohur pikaset në hapësirën ajrore të aeroportit të qytetit, ndërpriten uljet dhe ngritjet për 30 minuta](#)

23:00 Bota

[Paguan mbi 200 mijë dollarë që trupi të ngrijë pas vdekjes, brenda qendrës që premton një “shans të dytë”](#)

22:50 Bota / 6 komente

[Kishin dalë për peshkim, 15-vjeçari shpëtohet në Alaskë pas dy ditësh në varkën e përmbysur. Dy viktima](#)

21:20 Bota / 1 koment

[Gjykatësi amerikan: Plani i Trump për të përgjysmuar fuqinë punëtore të FEMA-s, ka shkelur ligjin](#)

21:00 Bota

[Tragjedi në Kili, azili i të moshuarve përfshihet nga flakët, humbin jetën 16 persona](#)

[Kremlini: Nëse Zelensky kërkon takim duhet të vijë në Moskë](#)

19:50 Bota / 2 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Unë jam me Petrit Malajn](#)

14:45 Blog / 57 komente

[‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...](#)

15:15 Rajoni / 63 komente

[BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-s...](#)

14:30 Rajoni / 30 komente

[John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?](#)

11:40 Blog / 20 komente

[VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...](#)

10:02 Politika / 7 komente

Blog Tema

[Demokracia jonë pa hardware dhe software?!](#)

08:23 Blog / 1 koment

[Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike](#)

18:43 Blog

[Besnik Dizdari, si dëshmi e kohës kur gazetaria ishte një profesion](#)

18:30 Blog / 7 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetaret ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Politika• Kronika• Editorial• Blog• Bota• Sport• Shëndeti• Turizëm | <ul style="list-style-type: none">• Sociale• Ekonomia• Antena• Rajoni• Kulturë• Lifestyle• Dossier• Hi-Tech |
| <ul style="list-style-type: none">• Kontakt• Te dhënat personale | |

- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.